



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
TEATRI KOMBËTAR I OPERAS, BALETIT DHE ANSAMBLIT POPULLOR

Nr 772 Prot

Tiranë më 23/12 /2021

NJOFTIM

Teatri Kombëtar i Operas, Baletit dhe Ansamblit Popullor, në mbështetje të Statutit të Institucionit të TKOBAP miratuar me urdhër të Ministrit të Ministrisë së Kulturës nr 166 datë 27.04.2015; Rregullores së Brendshme të Institucionit; Organikës dhe Strukturës së Institucionit miratuar me Urdhër të Kryeministrit nr 140, datë 28.03.2014, shpall 1 (një) vend vakant për pozicionin e punës Korist me specifikë zëri “Bariton” në Drejtorinë e Operas dhe Filarmonisë përkatësisht tek Sektori i Korit në TKOBAP.

❖ Korist “Bariton”

Për ti dhënë më shumë kohë shpërndarjes së informacionit për vende të lira pune në sektorët artistikë e për rrjedhojë për ti krijuar mundësi pjesëmarrjes më të madhe në numër të konkurrentëve TKOBAP nxjerrë njoftimin e saj 60 (gjashtëdhjetë) ditë përpara.

Njoftojmë të gjithë të interesuarit se në datën 03/03/2022 ora 14:00 në Sallën e Korit, në katin e IV brenda ambienteve të Teatrit Kombëtar të Operas, Baletit dhe Ansamblit Popullor do të zhvillohet audicioni për vendin vakant korist në sektorin e korit specifikë zëri bariton.

Të gjithë ata artistë të jashtëm të interesuar për pjesëmarrje për këtë vend vakant duhet të dorëzojnë pranë sekretarisë së TKOBAP deri me datë 24/02 /2022 ora 14:00 dokumentat e nevojshme për regjistrim si më poshtë vijon;

1. Të ketë kryer studimet e larta dega Kanto (bachelor ose master) brenda ose jashtë vendit;
2. Diplomë e përfundimit të shkollës dhe listë notash të noterizuara;
3. Fotokopje e dokumentit të identitetit ;
4. CV bashkëgjitur me Foto;
5. Një kopje të Curriculum Vitae bashkëgjitur me Foto, (veprimtaria e 2 viteve të fundit e çertifikuar, mastër class, work shop, programe koncertesh, recitalesh, shfaqje të ndryshme, si dhe të dhëna të tjera që plotësojnë figurën artistike, eksperiencë pune për figurën artistike që konkurojnë, etj). Dokumentacionin e nevojshëm për të vërtetuar këtë kriter;
6. Të ketë njohuri minimumi të dy gjuhëve të huaja italisht dhe anglisht.

Programi:

1. Shtrirja vokale (Vokalisë);
2. Tre arie të epokave të ndryshme nga repertori operistik, të përzgjedhura nga vetë kandidati, përkatësisht nga kompozitorët: W. A.Mozart, G.Rossini, V.Bellini, G.Verdi, G. Puccini, R. Leoncavallo, P. Mascagni, J.Massenet, G. Bizet, Ch. Gounod. R. Wagner;
3. Lexim me shikim të parë (a prima vista);
4. Pjesë korale të detyrueshme.

- J. Brahms – Ein Deutes Requiem, nr. 4 - Wie liblich sind deine Wohnungen
- G. Rossini - Stabat Mater, nr. 9 - Quando Corpus Morietur
- G. Verdi - Messa di Requiem, nr 7 - Libera me Domine, - fillon nga “Allegro Risoluto” deri në fund.
- G. Verdi – Otello - Fuoco di gioia
- C. Orff – Carmina Burana - In Taberna

Punoi kriteret e përgjithshme: Juriste Migena BIBA

Pranoi: Drejtor i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse Aida GEGAJ

Konceptoi artistikisht: Dirigjenti i Korit Dritan LUMSFI

Solist Lirik I Ylber GJINI

Spalë Sektori Kori Roza TOPI

MIRATOI

DREJTORE E PËRGJITHSHME

ZANA CELA

